



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 285/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Laziq dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë, paraqitur kundër komisionierit, për shkak të parregullsisë gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë

Arsyetim

Me datën 09.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, ku thekson se rreth orës 11:20 në VV 1934e/03, një votues Burim Kurti ka dashur të votoj me kusht por i njëjti nuk është udhëzuar për ndjekjen e procedurës së parapare me rregullat zgjedhore në fuqi që lidhen me votimin me kusht. Një parregullsi tjetër që ka vërejtur vëzhguesja e LVV është edhe zëvendësimi i kontrolluesit të rreshtit nga ana e një vëzhguesi të subjektit politik LDK –së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e parashtruesit të ankesës nuk qëndrojnë, sepse nga provat e ofruara në ankesë nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur një gjë e tillë Me këtë rast PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 285/2014 më datën 11.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.